



A.nr.209/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.209/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesit: N.A, D.H, F.K, B.O, R.K, A.H, D.E, G.H, K.K dhe K.A, të cilët i përfaqëson(më autorizim të përbashkët) ankuesi K.K, nga Gjilani, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.209/2026, e datës 25.02.2026, e parashtruar nga ankuesit N.A, D.H, F.K, B.O, R.K, A.H, D.E, G.H, K.K dhe K.A.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm administrativ në mënyrë që ankuesit ti bëhet kompensimi retroaktiv i diferencës së pagës së ekspertit (B7) nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit N.A, D.H, F.K, B.O, R.K, A.H, D.E, G.H, K.K dhe K.A, (*tutje referuar vetëm ankuesit*), më datë 25.02.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokoli 220/2026, të datës 18.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për mos njohjen e kompensimit retroaktiv të diferencës së pagës së papaguar sipas koeficientit B7 dhe atë nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 998/2026 të datës 25.01.2026 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 220 e datës 18.02.2026 nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së për ankuesit; Vendimin A.nr.235/2024 të KPMSHCK-së; Ankesën e datës 16.11.2023 nga u.d. Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së për Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike; Vendimin me Nr. 08/280 i datës 19.12.2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raporti i Punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rendes Strategjike; Akt Emërimet e ankuesve; Kopjet e ID-së së ankuesve; Kërkesën epur përgjigje në ankesë e datës 02.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 16.03.2026; Kërkesën e datës 15.10.2026 nga përfaqësuesi i ankuesve për Drejtorin e Përgjithshëm të SKPK-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

I. Vlerësimi i gjendjes faktike

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë kjo gjendje e fakteve:

-Ankuesi N.A sipas Akt Emërimit me Nr. 1424/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Departamentin për Teknologji Informative, ankuesja D.H sipas Akt Emërimit me Nr.1572/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtare e Teknologjisë Informative* në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ankuesi F.K sipas Akt Emërimit me Nr. 1705/2024, të datës 01.08.2024, mban pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Speciale, ankuesi B.O sipas Akt Emërimit me Nr.1986/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ankuesi R.K sipas Akt Emërimit me Nr. 1990/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ankuesi A.H sipas Akt Emërimit me Nr.1537/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ankuesi D.E sipas Akt Emërimit me Nr.2022/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Pejë, ankuesi Gëzim Hoxhaj sipas Akt Emërimit me Nr.1828/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Prizren, ankuesi K.K sipas Akt Emërimit me Nr.1782/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe ankuesi K.A sipas Akt Emërimit me Nr. 1498/2024, të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar i Teknologjisë Informative* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

-Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit Nr.23/165, të datë 12.10.2023, ka aprovuar Listën e Ekspertëve të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përfshirë edhe raportin e punës së Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike e ku sipas këtij raport si sisteme strategjike të Këshillit Prokurorial të Kosovës janë pranuar: *Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMR)*; *Qendra Primare e të Dhënave - Pallati Drejtësisë*; *Infrastruktura e Rrjetit dhe Komunikimit në KPK*, ndërsa, pozitat e ankuesve si zyrtar te IT-së nuk ishin përfshirë.

-Më datë 16.11.2023, u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kishte parashtruar ankesë tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që kishte të bënte me mos pranimin e disa sistemeve elektronike

dhe mos pranimin e Zyrtarëve të TI në kategorinë e Ekspertëve, duke kërkuar përfshirën e tyre si Ekspert sipas klasës B7.

-Ankuesit më datë 16.02.2024, kishin parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për mos përfshirje në listën e eksperteve, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.235/2024 të datës 02.04.2024, kishte aprovuar ankesën e ankuesve duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike.

-Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e vënëve të Punës në Administratës e Sistemit Prokurorial, ku pozitat e ankuesve janë përfshirë si kategori Ekspert i TI dhe klasës 7, e si rezultat i kësaj më datë 01.08.2024, i janë lëshuar akt emërimet sipas kësaj rregulloreje.

-Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 19.12.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 08/280 për aprovimin e Raportit të tretë të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, ku sipas këtij raporti në kuadër të listës së Ekspertëve janë përfshirë njëmbëdhjetë pozita të Zyrtarëve të Teknologjisë Informative në klasën B7.

-Ankuesit me datë 15.01.2026, i janë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me kërkesë për kompensim retroaktiv të pagës si Ekspert B7 nga muaji shkurt 2023 deri në muajin korrik 2024.

- Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 18.02.2026, sipas aktit me numër protokolli 220/2026 i është përgjigjur ankuesve në kërkesën duke e refuzuar të njëjtën me arsyetimin se për periudhën e kërkuar nuk ka ekzistuar asnjë akt emërim me koeficient 10.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se refuzimi i kërkesës redukton të drejtën në pagë dhe arsyetimi është krejtësisht jo i drejtë, duke pretenduar se një e drejtë për kompensim retroaktiv ju takon. Kërkojnë që ankesa të aprovohet, dhe të detyrohet Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës që të bëjë kompensimin retroaktiv të pagës prej datës 05.02.2023 deri më datë 10.07.2024 sipas koeficientit B7-10.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2, paragrafi 1: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenit 14, paragrafi 3: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nisur nga objekti i ankesës thekson faktin se më hyrjen në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria e Kosovës më datë 05.02.2023 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, në fuqi nga data 06.02.2023 deri me 26.08.2024, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, Qeveria e Kosovës duke u bazuar në nenin 6 të kësaj rregullore më Vendimin Nr.07/132, të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike (tutje SSHIKS) i cili komision ka nxjerrë dy raporte lidhur me njohjen e SSHIKS dhe listën e eksperteve të miratuara sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 dhe Vendimit Nr. 09/216, të datës 14.08.2024, e sipas të cilave akte pozita e ankuesit nuk ishte njohur si pozitë e ekspertit.

Rrjedhimisht sipas Raportit të parë të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, si sisteme të informimit dhe komunikimit me rëndësi strategjike për Këshillin Prokurorial të Kosovës, janë njohur: *Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMR); Qendra Primare e të Dhënave - Pallati Drejtësisë; Infrastruktura e Rrjetit dhe Komunikimit në KPK.*

Tutje, Qeveria e Kosovës më datë 27.08.2025 ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, më të cilën është shfuqizuar Rregullorja (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, ndërsa, më Vendimin 101/2230 të datës 13.11.2024, të Qeverisë së Kosovës është themeluar Komisioni i ri për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, mirëpo paraprakisht Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka miratuar Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e vënëve të Punës në Administratës e Sistemit Prokurorial, ku pozitat e ankuesve janë përfshirë si kategori Ekspert i TI dhe klasën B7, ndërsa, Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike ka nxjerr raportin e tretë lidhur me njohjen e sistemeve të reja me rëndësi strategjike dhe rrjedhimisht si pozita të Ekspertëve sipas klasës B7 ka përfshirë pozitat Zyrtarë të Teknologjisë Informative që mbajnë ankuesit, raport ky i miratuar nga Qeveria e Kosovës më Vendimin Nr.08/280, të datës 19.12.2025.

Kolegji i Këshillit bazuar në gjendjen faktike dhe juridike si me sipër konstaton se ankuesit janë ushtrues të pozitës së zyrtarit të IT-së që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, andaj, bazuar në qëndrimin e Këshillit për çështje të njëjta, e drejta e kompensimit të pagës së eksperti duhet të njihet nga data hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë gjegjësisht Rregullorja (QRK) Nr.11/2023 për Ekspertët, për të gjitha rastet kur sistemet e IT-së janë njohur nga komisioni gjegjes si sisteme strategjike mbi bazën e kësaj rregullore. Rrjedhimisht, qëndrim të tillë ishte dhënë në opinionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave, më datë 31.03.2023, të përcjell për të gjitha institucionet publike lidhur me efektet e ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me ç'rast sipas pikës 4 të opinionit sqarohet se: *Punonjës të cilëve vet shtojca përkatëse e Ligjit, u është përcaktuar klasifikimi i posaçëm, p.sh: ekspertë sipas shtojcës së posaçme, specialistët, inspektorët, punonjësit në arsim, shëndetësi, art, kulture e trashëgimi kulturore apo një fushë tjetër ? (vijon korrigjimi edhe në ditët dhe javët në vazhdim- pagat u barazohen retroaktivisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit).*

Andaj, theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të bëjnë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesit nga muaji shkurt i vitit 2023 deri në muajin korrik të vitit 2024, sipas koeficientit të përcaktuar B7.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.209/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve K.K;
- Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKPK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK -së;